



Procesi i të mësuarit dhe i zhvillimit të nxënëseve dhe nxënësve, kënaqësia për të mësuar dhe kënaqësia për përditshmërinë e përbashkët shkollor janë në qendër të vëmendjes.

Baza për një shkollë të suksesshme është mirëkuptimi mbi vlerat dhe normat themelore.

Parimi drejtues vlen për të gjitha shkollat, kopshtet e fëmijëve, shkollat ditore dhe për ofertat e kujdestarisë në qarkun shkollor Breitenrain-Lorraine. Orientimet bazë dhe sistemi i vlerave të përkrahura në parimin drejtues shërbejnë për të gjithë pjesëmarrësit si një direktivë e detyrueshme për sjelljet dhe veprimet e tyre.

Parimi drejtues e tregon imazhin largpamës të idealit të shkollës. Ky çon te masat konkrete, të cilat i kemi regjistruar në programin shkollor të detyrueshëm. Ky siguron vazhdimësinë dhe cilësinë e punës sonë. Ky shërben si bazë themelore për një zhvillim të qëndrueshëm të shkollës tonë.

Parimi drejtues i jep qarkut shkollor një profil të pavarur. Ky i ndërmjetëson publikut vizionet tona dhe jep një pasqyrim për prioritetet dhe synimet tona.

www.breitenrain-lorraine.ch

**breitenrain
lorraine**

Parimi Drejtues për Qarkun Shkollor
Breitenrain-Lorraine

Pune të ndryshme Koha Ngjyra Shumë mundësi Të jesh i pranuar
Eksperimentimi Punë e pavarur Humori Mediet Shtazët
Qetësi Rregullat Orë të tendosura Vende të ndryshme pune
Mësim i larmishëm Shprehja e lirë Të lëvizim Mësuese e mësues të mirë

Veprimi profesional pedagogjik

Ne mundësojmë, shoqërojmë dhe përkrahim shtigjet individuale dhe të gjithanshme të mësimit.

Ne angazhohemi për një mësim të kuptueshëm dhe të qëndrueshëm.

Ambient të mirë shkollor dhe kulturë stimuluese shkollore

Ne organizojmë rregullisht aktivitete në përkrahje të bashkësive dhe i kushtojmë vëmendje një ambienti mbështetës për mësim dhe kujdestari, në përkrahje të shëndetit.

Ne i kushtojmë vëmendje një bashkëpunimi konstruktiv dhe respektues me të gjithë pjesëmarrësit, veçanërisht me nxënëset dhe nxënësit, mësueset/mësuesit, drejtorët e shkollave, prindërit, autoritetet dhe institucionet e tjera, si dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Shkolla novatore dhe e hapur

Ne evoluojmë, reflektojmë dhe përmirësojmë rregullisht cilësinë e shkollës sonë.

Ne nisemi drejt të resë së bashku, të interesuar dhe guximshëm.

Organizatë shkollore me struktura të qarta dhe të arsyeshme

Ne i kushtojmë vëmendje ecurive të qarta dhe transparente, proceseve të vendimeve dhe informacioneve.

Ne përkrahim dhe jetojmë me format e përshtatshme të shprehjes së lirë.

Dialogu ndërmjet njerëzve me botëkuptime të ndryshme

Ne mbështetemi në resurse dhe në pikat e forta dhe shkëmbejmë lidhur me këto.

Ne jemi kureshtar për diversitetin dhe e takojmë tjetrin me respekt dhe sinqeritet.

Punë publike transparente

Ne kujdesemi për shkëmbim me lagjen dhe qytetin.

Ne angazhohemi për një rrjet kontaktimi dhe për një kooperim me të gjithë personat dhe institucionet pjesëmarrës/e në proceset e arsimit.